

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ALBANIAN DIGITAL MARKETING shpk**

- Z. Shpëtim Ahmet Palloshi, datëlindje 30.11.1946 qytetar shqiptar, me vendlindje në Elbasan dhe banim në Rr. Thoma Kalefi, Elbasan.

Kam vendosur të nënshkruaj Aktin e Themelimit e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është **ALBANIAN DIGITAL MARKETING Sh.p.k.**

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Elbasan, Rruga Shefqet Shyti, Nd. 6, H.20, Ap.3, 3001.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

- Agjensi për ndërmjetësim tregtar. Gjerimi i punëve të tjerëve (sipas parashikimeve të nenit 648-652 të Kodit Civil). Konsulencë në përgatitje dokumentacioni, ndjekje e të gjitha procedurave për regjistrim të shoqërive të krijuara rishtazi, deri në dhënien e licensës nga organi përkatës për fillimin e ushtrimit të aktivitetit. Shërbim marketingu, menaxhimi, administrimi, Konsulencë marrëdhënie tregtare, përpilim dhe depozitim dokumentash të shoqërive tregtare të regjistruara si subjekte të së drejtës shqiptare apo të huaj. Konsulencë në distancë dhe me anë të përfaqesuesve të brendshëm pranë shoqërive tregtare.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **10,000 leke** i cili nuk është i paguar.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar në nenin 6 (gjashtë) të këtij Akti.

Neni 6 - Kontributet

- 6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:



- Z. Shpëtim Ahmet Palloshi, datëlindje 30.11.1946 qytetar shqiptar, me vendlindje në Elbasan dhe banim në Rr. Thoma Kalefi, Elbasan, të cilit i përket një kuotë me vlerë nominale 10,000 leke, që i korrespondon 100% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 – Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Z. Shpëtim Ahmet Palloshi, datëlindje 30.11.1946 qytetar shqiptar, me vendlindje në Elbasan dhe banim në Rr. Thoma Kalefi, Elbasan, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

Neni 9– Gjuha

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.


Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

10.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan

ORTAKËT

Z. Shpëtim Palloshi

Shpëtim Palloshi


Datë 04.07.2022